



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.13, datë16/12/2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES NR.SERIE
000027, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.7, DATË 14.06.2022 PËR
PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR, SUBJEKTIT
“FATJON KAMBERI”**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime teknologjike (Lavazho) me Nr.serie:000027, miratuar nga KBU Ishëm me Vendim Nr.7, datë 14.06.2022, subjektit “Fatjon Kamberi”, me vendëndodhje, Shkozë, Bashkia Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- $X=487818.17$
- $Y=4577757.83$
- $Z=148\text{ m}$

- Prurja mesatare : $Q_{\text{mes}}=1.0\text{ l/sek}$
- Sasia e ujit në përdorim : $Q=0.3\text{ l/sek}$
- Qëllimi i përdorimit : Ujë teknologjik për larjen e automjeteve dhe tapicerive
- Shkarkimi i ujërave të përdorur : Rrjeti i kanalizimeve UK Tirana.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

